

Termet e Referencës (ToR) për Ekspert të Jashtëm të Ndotjes

Për Vlerësimin e Aplikimeve të thirrjes për Grantet Tematike dhe Rajonale – Projekti GreenAL

Emri i Projektit: GreenAL - Mbështetja e Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri (2024–2027)

Vendndodhja: Hibrade – Shqipëri

Kohëzgjatja: 5 ditë pune (Periudha e Vlerësimit)

Data e Fillimit: 8 Janar, 2025 (Periudhat dhe datat janë provizore dhe mund të ndryshojnë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktues.)

1. Konteksti

Projekti GreenAL mbështetet financiarisht nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Sida, me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat VIS Albania dhe COSV - Cooperazione per lo Sviluppo.

Nëpërmjet thirrjes për Grantet Tematike dhe Rajonale GreenAL synon të ofrojë mbështetje financiare për OSHC-të mjedisore, për të rritur dhe konsoliduar kapacitetet e tyre për të marrë pjesë aktive në proceset e politikëbërjes nga niveli lokal në atë kombëtar, me qëllim adresimin e sfidave mjedisore që ndikojnë në territore dhe komunitete.

Më specifikisht, GreenAL synon:

- Mbështetjen e OSHC-ve për të rritur kapacitetet e tyre për të nisur një dialog në nivel kombëtar, nëpërmjet monitorimit dhe advokimit për politika më të mira në fushën e ndryshimeve klimatike, ndotjes dhe natyrës;
- Fuqizimin e OSHC-ve dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe grupe të tjerë interesi për të qenë partner të institucioneve në hartimin dhe zbatimin e reformave me fokus kryesor Kapitullin 27, Mjedisin dhe tranzicionin e gjelbër nga niveli lokal në atë kombëtar.
- Ndërgjegjësimin dhe forcimin e komuniteteve për të nxitur presionin pozitiv nëpërmjet llogaridhënies në uljen e nivelit të ndotjes, mbrojtjes së biodiversitetit/habitateve, adaptimin dhe zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të thirrjes për grantet tematike dhe rajonale, GreenAL do të marri **25 propozime të plota** nga aplikantët që kanë kaluar fazën e parë të aplikimeve për koncept-ide, dhe synon të japë tre grante tematike dhe gjashtë grante rajonale. Afati përfundimtar për dorëzimin e këtyre aplikimeve është 6 Janar 2025, ora 16:00. Vlerësimi i propozimeve të plota do të zhvillohet midis datave 06.01.2025 – 28.01.2025. Për të siguruar një proces vlerësimi cilësor, GreenAL kërkon një Ekspert të Jashtëm për të ofruar një vlerësim teknik të pavarur për propozimet që kërkojnë ekspertizë specifike tematike për 5 ditë pune duke filluar nga data 08.01.2025.

2. Fushëveprimi i detyrës

Roli kryesor i Ekspertit të Jashtëm të Granteve është mbështetja e komisionit të vlerësimit në shqyrtimin teknik të propozimeve të plota, duke u fokusuar në detaje teknike specifike që lidhen me temën e ndotjes (ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës).

Eksperti i Jashtëm **nuk do të japë pikë**, por do të ofrojë komente tematike dhe sqarime për ekipin e vlerësimit për të siguruar përzgjedhjen e projekteve të realizueshme me fokus ndotjen.

3. Detyrat Specifike të Ekspertit

Eksperti do të fokusohet në propozime me përmbajtje që kërkojnë njohuri të thella mbi temën e ndotjes dhe çështje të tilla si matja dhe adresimi i ndotjes së ajrit, zhurmës, ujit dhe/ose tokës.

Eksperti i Jashtëm do të:

- Lexojë udhëzimet dhe kërkesat e thirrjes;
- Lexojë Metodologjinë Alternative të Monitorimit të Ndotjes;
- Shqyrtojë dhe ofrojë input tematik mbi temën e ndotjes për numrin e propozimeve të përzgjedhura për këtë vlerësim teknik;
- Analizojë realizueshmërinë e projektit, saktësinë teknike, përputhshmërinë me objektivat tematike të GreenAL dhe ndikimin e mundshëm mjedisor;
- Ofrimi i komenteve të shkruara dhe rekomandimeve për Komitetin e Vlerësimit mbi projekt-propozimet e shqyrtuara;
- Pjesëmarrja në diskutime sqaruese me Komitetin e Vlerësimit të GreenAL (sipas nevojës).

4. Dorëzimet

- **Raporti i Shqyrtimit Teknik:** Përmbledhje e inputeve për propozimet e përzgjedhura, duke theksuar pikat e forta teknike, dobësitë dhe çdo rekomandim për sqarim në këto propozime.
- **Komente specifike për propozimet:** Shënime me sugjerime për të përmirësuar realizueshmërinë teknike.
- **Pjesëmarrja në Takime:** Pjesëmarrja në 1-2 takime me Komitetin e Vlerësimit për diskutime ose sqarime (sipas nevojës).

5. Kualifikimet e Kërkuara

Kandidati **duhet të ketë:**

- Diplomë Master (ose më të lartë) në Shkenca Mjedisore ose fusha të ngjashme.
- Të paktën 5 vjet përvojë në vlerësimin e projekteve, këshillimin teknik ose zbatimin e projekteve mjedisore.
- Ekspertizë të dëshmuar në fushën e matjes dhe adresimit të ndotjes (ajrit, ujit, tokës ose zhurmës).
- Përvojë në punën me OSHC, projekte të financuara nga donatorët ose skema grantesh.

- Aftësi të mira analitike, raportimi dhe komunikimi.
- Njohuri të mira të gjuhës Shqipe.

Kandidati **nuk duhet** të ketë asnjë konflikt interesi me aplikuesit në thirrjen GreenAL. Kjo do të thotë se ai/ajo nuk mund të jetë pjesë e stafit të organizatave aplikuese dhe as të jetë i/e përfshirë si staf i jashtëm në këto organizata. Në rast se gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes lind ndonjë konflikt interesi, kandidati është i detyruar të njoftojë menjëherë autoritetin kontraktues.

6. Menaxhimi i Detyrës

- Kontrata e punës do të nënshkruhet me njërin prej partnerëve të GreenAL.
- Eksperti i Jashtëm i Granteve do të punojë nën mbikëqyrjen e Ekipit të Vlerësimit të Granteve të GreenAL.
- Vlerësimet do të kryhen në distancë me fleksibilitet për koordinimin e afateve kohore.
- Eksperti do të respektojë udhëzimet dhe standardet e konfidencialitetit të GreenAL.

7. Afati Kohor dhe Pagesa

- **Periudha e Vlerësimit:** Rreth 5 ditë pune, duke filluar nga data e dakordësuar me Autoritetin Kontraktues.
- **Niveli i Angazhimit:** Përafërsisht 5 ditë pune, në varësi të numrit të propozimeve që kërkojnë shqyrtim teknik.
- **Kushtet e Pagesës:** Do përcaktohen, bazuar në dorëzimet dhe oraret e miratuara të punës.
- **Pagesa (Bruto):** 200 EUR për ditë pune.

8. Procesi i Aplikimit

Ekspertët e interesuar ftohen të dorëzojnë:

1. Një **CV** ku evidentohen kualifikimet dhe përvoja përkatëse.
2. Një **propozim të shkurtër teknik** që përshkruan kuptimin e detyrës dhe qasjen që propozojnë.

Aplikimet duhet të dërgohen në info@greenal.al deri më 06.01.2025, ora 12:00.